URDHËR
Nr. 153, datë 18.7.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000/2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të VKM-së nr. 111, datë 2.3.2022, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë, shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë", të ndryshuar; dhe të VKM-së nr. 822, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për miratimin ose refuzimin e kërkesave për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, të cilat nuk janë objekt koncesioni, nënshkrimin e kontratave dhe transferimin e miratimeve, në zbatim të VKM-së nr. 822, datë 7.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", të ndryshuar, zëvendësministrit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Ceno Klosi.
2. Ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Ceno Klosi, për zbatimin e këtij urdhri.
3. Urdhri nr. 125, datë 12.10.2023, "Për delegim kompetence", shfuqizohet.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku